

Ankona, 26 nëntor 2019

## KOMUNIKATË SHTYPI

Një tërmet me magnitudë 6.4 ballë ka goditur brigjet veriore të Shqipërisë, mbrëmë në 02:54 me orën lokale. Sipas të dhënave të Institutit Kombëtar Italian të Gjeofizikës dhe Vullkanologjisë (Ingv) dhe të Shërbimit Gjeologjik Usgs të Sh.B.A.-së, tërmeti e ka pasur epiqendrën e tij në rreth 10 km larg qytetit të Durrësit dhe 31 km nga qyteti i Tiranës, duke shkaktuar të paktën shtatë viktima dhe dëme serioze në territor.

Duke pasur parasysh lidhjen e thellë që tash sa kohë ka bashkuar Adria Ferries me Vendin e shqiptarëve, Shoqëria italiane e lundrimit ka vendosur të aktivizojë brenda saj, një njësi krize për të reaguar menjëherë dhe për të dhënë mbështetje të menjëhershme, për çdo kërkesë me karakter urgjent dhe humanitar apo emergjencë shëndetësore që mund të arrijë dhe për të qenë në dispozicion të autoriteteve e institucioneve italiane dhe shqiptare.

Skuadra do të drejtohet nga Dokt. Roberto Mataloni, nga Dokt. Michela Rossi dhe Dokt. Gabriele Ubaldi që do të administrojnë çdo kërkesë dhe nevojë, për sa i përket operacioneve të asistencës për popullsitë e goditura nga tërmeti.

Shoqëria ka urdhëruar gjithashtu hapjen e një llogarie rrjedhëse të dedikuar për mbështetjen konkrete të popullatës shqiptare, viktimë e kësaj tragjedie të tmerrshme.

Më pas do të ketë azhurnime në lidhje me dhurimet.

ADRIA FERRIES SPA

Dott. Roberto Mataloni

